



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

PROJEKT VENDIMI

Nr.3 datë 14/09.2026

Mbi "Dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Arben Pal Daja i dëmtuar nga zjarri me dt.08.08.2026 banorë i Bashkisë Vau-Dejës"

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligji Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 41, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", pika 3, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Nr.263, datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhëzimi Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banasave për vitin 2016" si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër "Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve,"

Për sa më sipër, Kryetari i Bashkisë Vau - Dejës për të përballuar dëmet e shkaktuara nga zjarri i rënë në banesën e shtetasit **Arben Pal Daja** me dt.08.08.2026 që është banorë i fshatit Hajmel të Njësisë Administrative Hajmel të Bashkisë Vau-Dejës, i propozon Këshillit Bashkiak që me shumicë votash:

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Vau Dejës për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **z.Arben Pal Daja** (4 anëtarë në familje), në vlerën **40.000** (katerdhjete mijë) lekë për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri .
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Vau Dejës , për familjen e **z.Arben Pal Daja** në vlerën totale të dëmit **838.324.³⁸** (tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e njëzet e katër pikë tridhjetë e tetë) lekë.
3. Të miratojë dhënien e kompensimit sipas proces verbalit të vlerësimit i hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në masën **50%** të vlerës totale në shumën **419.162.¹⁹** (Katërqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy pikë nëntëmbëdhjetë) lekë.
4. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorit të dëmtuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

5. **Burimi i financimit** do të jetë fondi i kushtëzuar i planifikuar për programin e Mbrojtjes Civile nr.429/6 dt.15.04.2026 mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit i protokolluar nga ana jonë me shkresën nr.3136 prot dt.20.04.2026.

Konfirmoi bazen ligjore

[Signature]

Konfirmoi bazen financiare

[Signature]

Konceptoi

Valjeta NIKAJ

[Signature]

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETARI

Aleksandra GJONI

KRYETARI

Kristian SHKRELI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

Numri i praktikës: 5828

Hajmel,me: 12/08/2026

KËRKESË

Unë i/e nenshkruari/a Arben Pal Daja me numër personal G90806022, banues në Hajmel Njesia Administrative Hajmel, dhe numer celulari 0675739678, në bazë të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe Kodit të Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë i drejtohem Sektori i Emergjencave Civile Kerkese per Verifikim te Demtimit te Objetit (banese) të Bashkisë Vaut Dejës me kërkesën e mëposhtme:

KËRKOJ

Kerkese per demshperblim si pasoje e Zjarrit te rene ne banesen e Z.Arben Pal Daja

Nisur nga ngjarja e ndodhur ditën e shtunë me datë 08-08-2026 si pasoje e një shkendije të energjisë elektrike në banesën time ka rene një zjarr i cili me ka djegur komplet banesën në të cilën jetoj prej vitesh. Duke qene se demet e zjarrit janë shumë të mëdha pasi janë djegur jo vetëm banesa por të gjitha orëndite shtëpiake që ishin brenda në banesë kërkoj nga ana juaj të vini në terren për të verifikuar nga afer demin e shkaktuar nga zjarri i asaj dite

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe gadishmerinë tuaj pres një përgjigje konkrete nga ana juaj pasi në ndodhemi prej asaj dite jo vetëm shumë të renduar e të tramatizuar psikologjikisht por dhe të pa sistemuar akoma

Aplikanti

Arben Daja

Specialisti i Zyrës me Një Ndalesë

Zana EECI

Zyra me një Ndalëse Hajmel

Relacion

Objekti: "Ndërtese (banesë) 1 katëshe me ku jeton familja e z.Arben Pal Daja.

Vendodhja: Hajmel,Nj.A, HAJMEL, Z.K 1920, Nr. pas 332/5 Bashkia Vau-Dejes

Bazuar në urdhin e punës Nr.658 dt.20.08.2026 të ngritur nga titullari i Bashkisë Vau Dejës me Nr.5881 Prot., datën 20.08.2026, grupi i punës verifikoi gjendjen në banesën e z.Arben Pal Daja.

Banesa ndodhet në fshatin Hajmel të Njësisë Administrative Hajmel të Bashkisë Vau Dejës, në zonën kadastrale 1920, Nr.pasurie 332/5 me sipërfaqe ndertese 29.88 m² në pronësi të z.Arben Pal Daja. Gjatë inspektimit në terren u kryen matjet e banesës, nga të cilat rezultoi se banesa është me përmasa (sipas planimetrisë bashkëngjitur),me sipërfaqe totale rreth 29.88 m². Banesa është e ndërtuar me mur tulle çeramike, i cili edhe pse është i përfshirë nga zjarri nuk paraqet dëmtime strukturore, përveç rënies dhe dëmtimit të suvatimeve dhe dyerve. Shkak i zjarrit ka qene energjia elektrike. Në kushte të tilla, kjo banesë eshte e pabanueshme.

Në vlerësimin e dëmëve të objektit, janë marrë parasysh çmimet e referencës nga Enti Kombëtar i Banesave, si dhe në përzgjedhja e zërave të punës është bërë në mënyrë të tillë, që banesa të rikthehet në gjendjen e saj fillestare, para se të përfshihej nga zjarri.

Punimet ndërtimore që duhet të kryhen në këtë banesë janë si më poshtë:

- Suvatim i brendshem mur tulle llac i perzier i perzier
- Suvatim tavani
- F.V dyer duralumini me mentesha/ dopio xham
- Lyerje me boje plastike

Punoi : Greta Matija



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU-DEJES

SEKTORI I MZSH-s

N° 5798/1 Prot

Vau Dejës me, 25/08/2026

VËRTETIM

Për rënie zjarri

Vërtetohet se me datë 08/08/2026, rreth orës 20⁰⁰ kemi marrë njoftim se në fshatin Hajmel. Njesia Administrative Hajmel. Bashkia Vau Dejës, kishte rënë zjarr në ndome jashtë banesë e cila cila shërbente si dhomë ndenje dhe guzhinë. Duke parë vendin e ngjarjes Vatra e zjarrit mendohet të ishte në sobën e gatimit. Si pasojë e zjarrit u dogjën disa paisje që ndodheshin brenda dhomes. Zjari u gjet pothuajse i fikur nga vete familja.

Ky vërtetim mbahet në tre kopje dhe përpilohet me kërkesën e të interesuarit për ta përdorur sipas nevojës.

Shefi Sektorit i MZSH-së

Glen RROTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KRYETAR

Nr. 5881 Prot

Vau-Dejes, me dt. 20/08/2026

URDHËR

Nr. 658 date 20/08/2026

Mbështetur në ligjin Nr.45/2019 datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen Civile", VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhëzimi Nr.1185/1 "Për kriteret, rregullat dhe procedurat e përdorimit të fondit të Emergjencave Civile planifikuar në buxhetin vjetor të Ministrisë së Punëve të Brendshme", i ndryshuar, për verifikimin e rastit të dëmtimit nga zjarri dt.08.08.2026 në banesën e shtetasit **Arben Pal Daja** banorë në fshatin Hajmel të Njesisë Administrative Hajmel të Bashkisë Vau Dejës sipas kërkesës me nr. Praktike 5828 dt.12.08.2026 .

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit të mëposhtëm për verifikimin e rastit të dëmtimit nga zjarri të banesës së shtetasit **Arben Pal Daja** banorë i fshatit **Hajmel** të Njesisë Administrative **Hajmel** të Bashkisë Vau-Dejës

a. Valjeta Nikaj	Kryetare
b. Greta Matija	Anëtar
c. Ardian Firza	Anetar

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri komisioni i lartpërmendur.
3. Afati për përpilimin e proces verbalit të konstatimit dhe të vlerësimit të rastit është data 24/08/2026.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi
Valjeta Nikaj

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETARI

Aleksandra GJONI

KRYETARI

Kristian SHKRELI

PREVENTIV

Objekti: "Ndërtese (banesë) 1 katëshe ne pronësi të familjes z.Arben Pal Daja

NR.	Nr. Analize	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH
1	310	Suvatim i brendshem mur tulle llac i perzier i perzier	m2	50.18	617.00	30,961.06
2	300	Suvatim tavani	m2	29.88	914.00	27,310.32
3	An.	F.V dyer duralumini me mentesha/ dopio xham	m2	4.00	10,401.00	41,604.00
4	404/1	Lyerje me boje plastike	m2	80.06	150.00	12,009.00
Shuma Analizave						111,884.38

Punoi: Ing. Greta Matija



KRYETARI I BASHKISE
Kristian SHKRELI

ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETARI

Aleksandra GJONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU-DEJES
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. _____ Prot

Vau Dejës, më 21.08.2026

PROCES VERBAL KONSTATIMI

I Mbajtur sot me datë **21.08.2026** në fshatin Hajmel të Njesisë Administrative Hajmel të Bashkisë Vau-Dejës nga komisioni i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë **Nr.658 dt.20.08.2026 me nr.5881 prot dt.20.8.2026** për konstatimin e kërkesës me nr praktike 5828 të shtetasit **Arben Pal Daja** mbi rënien e zjarrit në banesën e tij me dt.08.08.2026.

Gjatë verifikimit në vend u konstatua:

Banesa është ndërtuesë 1 katëshe e ndërtuar në vitin 2002 ku janë kuzhinë+salon me sipërfaqe 29.88 m².

Zjarri ka rënë në banesën e shtetasit **Arben Pal Daja** me dt. 08.08.2026, ku fatmirësisht nuk ka humbje jetësh. Banesa është dëmtuar pjesërisht nga ana ndërtimore. Gjithashtu janë dëmtuar të gjitha mobileritë,orenditë dhe pajisjet elektro-shtëpiake si më poshtë:

Nr	Emertimi	Sasia (copë)
1.	Televizor Samsung 50 Pol	1
2.	Frigorifer Ariston e3d	1
3.	Frigorifer Gorenje	1
4.	Sobe Gorenje	1
5.	Furre Elektrolux	1
6.	Mikrovale Gorenje	1
7.	Aspirator Gorenje	1
8.	Kondicioner Vivax 18	1
9.	Lavatriçe Ariston	1
10.	Lavatriçe Gorenje	1
11.	Komplet kolltuqe	1
12.	Minibare kine	1

13.	Minibar	1
14.	Etazher	1
15.	Tavoline mesi	1
		15(cope)

Bashkëlidhur këtij proces verbali do të gjeni edhe kopjen e Planimetrisë së banesës së shtetasit **Arben Pal Daja** banorë në fshatin Hajmel të Njesisë Administrative Hajmel të Bashkisë Vau-Dejës.

KOMISIONI

Valjeta Nikaj



Greta Matija



Ardian Firza


MIRATOHET
KRYETARI
 Kristian SHKRELI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETARI

Aleksandra GJONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU-DEJES
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Vau-Dejes, me 21.08.2026

MIRATOHET

KRYETARI
Kristian SHKRELI

ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETARI
Aleksandra GJONI



Vlerësimi i dëmeve në mobileri, orendi, pajisje elektroshtepiake

Në mbështetje të V.K.M Nr. 329, datë 16/05/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", vlerësimi i dëmeve sipas komisionit të vlerësimit për: mobileri ,orendi, pajisje elektro-shtëpiake të dëmtuara nga zjarri në objektin e banimit të **z.Arben Pal Daja** është:

Nr	Emertimi	Sasia (cope)	Çmimi	Vlera
1.	Televizor Samsung 50 Pol	1	125.600	125.600
2.	Frigorifer Ariston e3 d	1	90.000	90.000
3.	Frigorifer Gorenje	1	63.960	63.960
4.	Sobe Gorenje	1	43.980	43.980
5.	Furre Elketrolux	1	45.500	45.500
7.	Mikrovale Gorenje	1	39.600	39.600
8.	Aspirator Gorenje	1	18.840	18.840
9.	Kondicionere Vivax 18	1	46.260	69.900
10.	Lavatriçe Ariston	1	57.000	57.000
11.	Lavatrice Gorenje	1	32.760	32.760
11.	Komplet kolltuqe	1	48.300	48.300
12.	Minibare kine	1	38.000	38.000
13.	Minibar	1	32.000	32.000

14.	Etazher	1	11.000	11.000
15.	Tavoline mesi	1	10.000	10.000
Shuma				726.440

Vlerësimi i mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake është bërë në bazë të shkresës Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër "Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve"

Vlerësimi i zërave të punimeve është bërë në mbështetje të V.K.M Nr. 329, datë 16/05/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", kapitulli III, pika 2 germa ç, si dhe Udhëzimin Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave për vitin 2016, ku vlera e objektit të dëmtuar sipas zërave është **111.884.³⁸** (Njëqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër mijë pikë tridhjetë e tetë) lekë sipas tabelës së poshtëshënuar

Nr.	Nr. Analize	Emërtimi i punimeve	Njesia	Sasia	Çmimi pa Tvsh	Vlera pa TVSH
1	310	Suvatim i brendshëm mur tulle llac i perzier i perzier	m ²	50.18	617.00	30,961.06
2	300	Suvatim tavani	m ²	29.88	914.00	27,310.32
3	An.	F.V dyer duralumini me mentesha/ dopio xham	m ²	4.00	10,401.00	41,604.00
4	404/1	Lyerje me boje plastike	m ²	80.06	150.00	12,009.00
Totali						111,884.³⁸

ndërsa vlera e dëmeve në mobilje, orendi dhe pajisje elektroshtëpiake është **726.440** (shtateqind e njezet e gjashtë mijë e katërqind e katërdhjetë)leke dhe vlera totale e dëmit është **838.324.³⁸** (Tetëqind e tridhjetë e tetëmijë e treqind e njezet e kater pike tridhjetë e tete)

Komisioni:

Valjeta Nikaj



Greta Matija



Ardian Firza

